



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1 Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr.373/ Prot.

Tiranë, më _____

V E N D I M

Nr.93, Datë 30.09.2019

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E ALUIZNI-t QARKU
KORÇË "MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR,
PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR
LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE" për periudhën nga data
01.01.2017 deri më datën 30.05.2019.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimin dhe Integritet të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Korçë rezultoi që, veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim të çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim e objekteve informale, nuk ka qenë plotësisht efektive, rrjedhojë e mangësive procedurale në zbatimin e ligjshmërisë dhe në hartimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale" të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimin dhe Integritet të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Korçë, sipas programit të auditimit nr.373/1, datë 28.05.2019 i ndryshuar me nr. 373/2, datë 17.07.2019, për veprimtarinë nga data nga 01.01.2017 deri në 30.05.2019.

II. Të miratoj Opinionin e Auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. KONKLZIONI DHE OPINION I AUDITIMIT

Ne kemi audituar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë (sot Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë), në mbështetje të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe (ISSAI 4100¹) për të cilën do të japim opinion:

- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë) në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal”, në të gjitha rastet e audituara ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”. Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë Bashkive rang Qarku, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për 1706 objekte informale dhe pa marrë konfirmim mbi pagesën e saj për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën 47,337,161 lekë;

- Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Korçë për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2017 deri 31.05.2019 janë lëshuar 3386 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Nga 3386 leje legalizimi të lëshuara, 2431 leje legalizimi ose rreth 72 % e tyre lejet e legalizimit janë lëshuar vetëm për objektin me shënimin në lejen e legalizimit “Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave” referuar V.K.M. nr.954, datë 25.11.2015 dhe V.K.M. 1095, datë 28.12.2015”. Për 2431 leje legalizimi nuk është arkëtuar detyrimi i parcelës ndërtimore në vlerë 123,946,690 lekë dhe Bono Privatizimi. Veprim në kundërshtim me ligjin 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17 (pika 5)

-Në 51 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi: Në 13 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët, madje është cënuar trupi i rrugës ku sipas Gen Planit të administruar në dosje rezulton se objektet bien mbi rrugë a trotuar; Në 5 rast është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar në buzë të lumit, përroi, kanal dhe digë pa respektuar distancat nga brigjet dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit; Në 15 raste me sipërfaqe prej 3232.1 m², sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Pyll”. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”; Në 1 rast Sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, fotove të objektit dhe pamjes grafike të ASIG rezulton se objekti është i vjetër dhe ndërtuar jashtë fushës së zbatimit të ligjit; Në 3 raste, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur dhe pamjes grafike të ASIG rezulton se objekti ndodhen mbi një objekt tjetër, dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej verifikimit të pronësisë së parcelës ndërtimore si dhe marrëdhënieve me objektin e vjetër; Në 3 raste, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, fotove të objektit dhe pamjes grafike të ASIG rezulton se objekti është i ndërtuar me objekte jo të qëndrueshme (llamarinë etj.) dhe pa lidhur pazgjidhshmërisht me tokën; Në 4 raste Sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si vetëdeklarimi (i regjistruar edhe në faqen zyrtare të ALUIZNI-t) fotografitë e objektit si dhe imazhet satelitore konstatohet se objekti informal i vetëdeklaruar është ndërtuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar; Në 4 raste në Procesverbalin e Verifikimit në Terren nuk është përcaktuar funksioni i ndërtimit informal, ndërsa në planimetritë që shoqërojnë Lejen e Legalizimit është përcaktuar funksioni; Në 1 rast, Leja e Legalizimit me nr. 160530, datë 18.11.2016 Objekti “Shtesë anësore ekonomike 2 kate me bodrum”. Parcela

¹ ISSAI 4100 - Objektiv i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet veçmas me auditimin e pasqyrave financiare.

ndërtimore 560 m², sipërfaqja e ndërtimit 274 m², është lëshuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pasi: Parcela ndërtimore në të cilën ndodhet objekti 2 kat është në territorin e publik; Në 1 rast, Leja e Legalizimit me nr. 160755, datë 19.04.2017 është dhënë për një objekt në një zonë me sistemin, konservim natyror, jashtë zonës së përcaktuar për banim; Në 1 rast, Leja e Legalizimit me nr. 22333645, datë 15.02.2019 është lëshuar në zonë me përparësi në zhvillimin e turizmit

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2016 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”; VKM Nr. 280, datë 1.4.2015, (I ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016), “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” dhe aktet e tjera nënligjore.

*Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, i kryer në subjektin Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë), nuk u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim **opinion të kualifikuar me rezerve**².*

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: -Në 24 raste “Proces verbalin e verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa leje/shtesë në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë vetëm me numrin pasurie pa përshkrim, nuk janë përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës. Skicat fushore pasqyrojnë përmasat e objektit informal, por nuk kanë të pasqyruara: ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen plan, planimetri) (Trajtuar në faqet 23-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë të marrë masa për 24 rastet e konstatuara e në vijim, për të plotësuar “Proces verbalin e verifikimit në terren të dhënave të ndërtimit pa leje/shtesës në ndërtimin me leje”, me të dhënat e kërkuara edhe me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij. Në rastin e mos plotësimit, të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë të Kadastrës Shtetërore dhe t’i kërkojnë Ministrisë së Drejtësisë, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit.

Brenda muajit Dhjetor 2019

2. Gjetje nga auditimi: - Në 28 raste nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë) nuk është respektuar **afati 60 ditor** për marrjen e vendimit për kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren, ndërkohë që **në 5 raste** nuk është respektuar **afati 30 ditor** për lëshimin e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit, veprime këto në kundërshtim me: pikën 8 të VKM Nr.280, datë 01.04.2015 i ndryshuar, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar, si dhe pika 2 e VKM Nr. 954, datë 25.11.2015 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit” me ndryshime (Trajtuar në faqet 23-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

²“Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit”

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë të marrë masa dhe të përgatisë plane konkrete, për të shqyrtuar kërkesat për legalizim sipas zonave informale dhe brenda afateve të përcaktuara ligjërish, duke mundësuar afrimin e shërbimit të kërkuar nga qytetarët në kohë duke rritur edhe transparencën për publikun.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë) në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal”, në të gjitha rastet e audituara ka vepruar në kundërshtim me ligjin Nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” –**“vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”**. Në kualifikimin e objekteve informale, ka dërguar pranë Bashkive rang Qarku, vetëm shkresën për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për 1706 objekte informale dhe pa marrë konfirmim mbi pagesën e saj për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një **mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit në vlerën 47,337,161 lekë** (Trajtuar në faqen 23-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t’i kërkojë Bashkive Korçë, Maliq, Pogradec, Devoll dhe Kolonjë, vërtetimet mbi llogaritjen e likuidimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në **vlerën prej 47,337,161 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të kartelës** Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë, **në refuzim të vendosën masë për kufizimet deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.**

Brenda muajit Dhjetor 2019

4. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Korçë (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë) për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2017 deri 31.05.2019 janë lëshuar 3386 leje legalizimi për objektet informale të legalizuara. Nga 3386 leje legalizimi të lëshuara, 2431 leje legalizimi ose rreth 72 % e tyre lejet e legalizimit janë lëshuar vetëm për objektin me shënimin në lejen e legalizimit “*Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave*” referuar VKM nr.954, datë 25.11.2015 dhe VKM nr. 1095, datë 28.12.2015”. Për 2431 leje legalizimi nuk është arkëtuar detyrimi i parcelës ndërtimore në vlerë **123,946,690 lekë** dhe bono privatizimi. Veprim në kundërshtim me ligjin 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, neni 17 (pika 5) (Trajtuar në faqet 23-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, deri në daljen e VKM-ve për **2431 dosje** të objekteve informale të pajisur me leje legalizimi të objektit, **për të mundësuar brenda afateve ligjore** likuidimin të vleftës së parcelave ndërtimore në shumën prej **123,946,690 lekë** dhe bono privatizimi.

Brenda muajit Dhjetor 2019

5. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë (aktualisht pjesë e Drejtorisë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë) për periudhën objekt auditimi në procesin e legalizimit sipas blloqeve kadastrale apo sipas Njësive të Vetëqeverisjes Vendore rezultojnë dosje të objekteve informale që megjithëse janë përfunduar verifikimi në terren dhe hartimi i dokumentacionit ligjor të kërkuar, nuk kanë vazhduar procedurat kualifikuese dhe pajisja me leje legalizimi pa arsye të dokumentuara në dosje duke shkelur edhe afatet ligjore të përcaktuara konkretisht sipas 55 subjekteve.

veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 27, 28 si dhe VKM 589, datë 10.09.2014, pika 10 i ndryshuar me VKM nr. 634, datë 7.9.2016 si dhe VKM 280, datë 01.04.2015 i ndryshuar, kreu i IV, pika (8) (*Trajtuar në faqet 23-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë, për **55 objekte** informale që kanë përfunduar verifikimi në terren dhe hartimi i dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe nuk kanë vazhduar procedurat kualifikuese dhe pajisjen me leje legalizimi, të operojë me vazhdimin e procedurave të legalizimit duke i trajtuar në funksion të afatit kohor duke kryer kualifikimin e tyre deri në lëshimin e lejes së legalizimit.

Deri më 30.10.2019

6.Gjetje nga auditimi: Në 50 raste, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, *pasi:*

- Në **13 raste**, janë kryer legalizime të objekteve **pa respektuar distancat nga rrugët**, madje është cënuar trupi i rrugës ku sipas Gen Planit të administruar në dosje rezulton se objektet bien mbi rrugë a trotuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 39 “Përjashtimi nga legalizimi” me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara” -VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2; ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor;

- Në **5 raste** është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar **në buzë të lumit, përroi, kanal dhe digë pa respektuar distancat nga brigjet** dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion justifikues për këtë qëllim. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5, ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” Kreu III, pika 4, germat: “dh”;

-Në **15 raste me sipërfaqe prej 3232.1 m²**, sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Pyll”. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” i ndryshuar, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Trull”

-Në **4 raste** në procesverbalin e verifikimit në terren **nuk është përcaktuar funksioni i ndërtimit** informal, ndërsa në planimetritë që shoqërojnë lejen e legalizimit është përcaktuar funksioni veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar neni 3 “Përkufizime” pika “a”, si dhe neni 17 “Kalimi i së drejtës së pronësisë dhe mënyra e pagesës së parcelës ndërtimore” pika 3.

- Në **1 rast** Sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, fotove të objektit dhe pamjes grafike të ASIG rezulton se objekti është i vjetër dhe ndërtuar **jashtë fushës së zbatimit** së ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Në dosjen e dokumentacionit për legalizim ka të depozituar edhe certifikatë pronësie të njehsuar me origjinalin për Pasurinë nr. 3/905 në ZK 8561 regjistruar në

Kartelën e pasurisë vol. 33, faqe 147 për 169 m² “truall”. Në Kartelën e pasurisë nr. 3/905-ND në seksionin “D” ka shënimin “Mbi këtë truall ka ndërtim me kontratë shitje është blerë trualli.”

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: nenin 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, pika 13.

-**Në 3 raste**, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur dhe pamjes grafike të ASIG rezulton se objekti ndodhen mbi një objekt tjetër, dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej verifikimit të pronësisë së parcelës ndërtimore si dhe marrëdhënieve me objektin e vjetër, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion justifikues për këtë qëllim. Veprimet janë në kundërshtim me: nenin 39, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar pika 13.

-**Në 3 raste**, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, fotove të objektit dhe pamjes grafike të ASIG rezulton se objekti është i ndërtuar me objekte jo të qëndrueshme (llamarinë etj.) dhe pa lidhur pazgjidhshmërisht me tokën pra **jashtë fushës së zbatimit** së ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Veprimet në kundërshtim me: nenin 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006; VKM nr.280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar pika 1 e 7.

- **Në 4 raste** Sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si vetëdeklarimi (i regjistruar edhe në faqen zyrtare të ALUIZNI-t) fotografitë e objektit si dhe imazhet satelitore konstatohet se objekti informal i vetëdeklaruar **është ndërtuar jashtë afatit ligjor** të përcaktuar, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, nenin 2 “Fusha e zbatimit”; me VKM nr.589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale” i ndryshuar, pika 3 e 3/1.

- **Në 1 rast**, Leja e Legalizimit me nr.160530, datë 18.11.2016 Objekti “Shtesë anësore ekonomike 2 kate me bodrum”. Parcela ndërtimore 560 m², sipërfaqja e ndërtimit 274 m², është lëshuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pasi: Parcela ndërtimore në të cilën ndodhet objekti 2 kat është **në territorin publik**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2016 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenet 27 dhe 41 konkretisht: neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit” pika d *si dhe* neni 41 “Kriteret për legalizimin e shtesave”.

- **Në 1 rast**, Leja e Legalizimit me nr. 160755, datë 19.04.2017 Objekti “Godinë banimi 2 kat me ambjent ndihmës 1 kat”. Parcela ndërtimore 514.2 m², sipërfaqja e ndërtimit 207.6 + 35.8 m² me sipërfaqe totale për shërbim 425.6 m². Në favor të A. T., referuar Genplanit, ortofotos dhe dokumentacionit shoqëruar Lejen e Legalizimit është dhënë **për një objekt në një zonë me sistemim, konservim natyror**, jashtë zonës së përcaktuar për banim pasi në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Korçë Miratuar me vendim të K.K.T-se, nr 7, datë 08.02.2017 zona është zonë ku nuk lejohen ndërtime banimi (e njëjtë është edhe në PPV Bashkia Korçë miratuar me Vendim KKT nr. 13, dt. 07.03.2014). Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, si dhe me VKM Nr. 280, datë 1.4.2015, (i ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016), “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” (*Trajtuar në faqet 23-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Drejtësisë, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Brenda muajit Dhjetor 2019

7.Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë është lëshuar Leja e Legalizimit me nr. 161001, datë 13.09.2017 Objekti “Godinë banimi 1 kat”. Parcela ndërtimore 362 m², sipërfaqja e ndërtimit 35.7 m². Në favor të M. I. Poseduesi, sipas Deklaratës Noteriale me nr. 2015 Rep., nr. 819 Kol. ,datë 21.09.2017 ka deklaruar se ka prishur një pjesë të ndërtesës së vjetër e në themelet e saj ka ndërtuar një ndërtim të ri dhe është dakort të blejë truallin në posedim mbi tre fishin e sipërfaqes së ndërtimit. Me VKM nr. 293, datë 21.05.2018 “Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre” është miratuar kalimi i pronësisë së truallit prej 221 m² në favor të M.I. Nga ana e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Korçë nuk është vepruar në përputhje e zbatim të ligjit nr 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, nenin 17 “Kalimi i së drejtës së pronësisë dhe mënyra e pagesës së parcelës ndërtimore”. Për poseduesin e ndërtimit pa leje M.I. duhet të ishte llogaritur **detyrimi i parcelës ndërtimore prej 2,001,155 lekë** (221 m² x 9055 lekë/m²) (*Trajtuar në faqet 23-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë të marrë masa që në zbatim të VKM nr. 293, datë 21.05.2018 “Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre”, mbështetur në Deklaratën Noteriale me nr. 2015 Rep., nr. 819 Kol. ,datë 21.09.2017, të njoftojë e të marrë masa që z. M.I. të arkëtojë **detyrimin financiar prej 2,001,155 lekë** (221 m² x 9055 lekë/m²) **për kalimin e parcelës ndërtimore në pronësi të tij.**

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë është lëshuar Leja e Legalizimit me nr. 22333645, datë 15.02.2019. Objekti “godinë banimi 2 kat”. Parcela ndërtimore 436.8 m², sipërfaqja e ndërtimit 145.6 m² sipërfaqe totale banimi 296 m². Vendimi “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal në posedim të V.D.,I.D.” nr. 149, datë 15.02.2019.

- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë ka pranuar Deklaratën e vetëdeklarimit të ndërtimit inforal, pa u shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar në kundërshtim me Udhëzimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 767, date 10.09.2014 “Për miratimin e formës dhe mënyrës së plotësimit dhe administrimit te deklaratës për përfshirjen ne procesin e legalizimit të ndërtimit pa leje” dale ne zbatim te nenit 4 te ligjit nr. 9482, data 03.04.2006, i ndryshuar si dhe pikat 2 e 3.b të VKM nr. 589, date 10.09.2014 i ndryshuar.

-Ne procesin e legalizimit në Drejtorinë Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë është paraqitur një ankese nga z. I.D. me nr. 3704 Prot., date 30.05.2018 i cili parashtroi ankesën pasi “Komshiu (në këtë rast V.D.,I.D.) te cilit ne mirëkuptim i kam lënë hyrje për objektin e tij ne truallin tim kërkon te legalizojë truallin tim ne emrin e tij” Ne këtë rast duhet te ishin pezulluar procedurat e legalizimit për të vërtetuar ndjekjen gjyqësore te konfliktit kjo ne zbatim e përputhje me VKM nr. 954, date 25.11.2015 “Për përcaktimin e kriterëve. te procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit ” i ndryshuar pika 8.

- Leja e Legalizimit me nr. 22333645, datë 15.02.2019 është marrë në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, pasi sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objekti ndodhet në zonë me përparësi në zhvillimin e turizmit neni 38/1; VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtesa anësore dhe /ose në lartësi në ndërtimet me leje”, ndryshuar

me VKM nr. 756, datë 26.10.2016, Kreu III, pika 6 (*Trajtuar në faqet 23-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: : Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë:

1. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi nr.22333645, datë 15.02.2019. Objekti “godinë banimi 2 kat” dhënë në kundërshtim, me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit.

2. Për pasurinë nr. 49/38-ND vol.6, fq. 91 në ZK 1446 Dardhë Korçë regjistruar sipas leje legalizimi nr. 22333645 datë 15.02.2019 konstatuar e lëshuar me shkelje të marrë masa në bazë të neni 27 pika 1 e 4 të ligjit 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë, sektori i financës dhe sektori i Legalizimeve të rakordojne dokumentacionin dhe raportojnë të ardhurat për buxhetin e shtetit nga procesi i legalizimeve dhe transferimi i pronësisë çdo fund muaji, 3/mujor e çdo vit mbështetur në identifikimin e numrit dhe të datës së lejes së legalizimit, emër mbiemër të personit (dhe jo vetëm identifikimi personi, pasi i njëjti person zotëron mbi një e më shumë objekte apo leje) në mbajtjen e ditarit të përshkruhet, vendoset në korrespondencë, përveç identifikimit të lejes legalizimit, dokumentet justifikues faturat autorizimet, shkresat ndaj NJQVV-ve, lëshuar personave përfitues të lejeve të legalizimit, me synim bashkërendimin ndërmjet sektorëve, vendosjen e funksionimit të sistemit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm në administrimin hartimin dhe qarkullimin e dokumentacionit të lëvizjes së aktiveve që përbejnë të ardhura për buxhetin e shtetit nga procesi i legalizimeve dhe transferimi i pronësisë, por edhe evidentimin, identifikimin e barrëve mbi pasurin (me origjinë nga legalizimet) në procesin e mëvonshëm të regjistrimit të pasurive të legalizuara, në përmbushje të kërkesave të ligjit “Për Kadastrën” (*Trajtuar në faqet 87-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandim: Të hartohet rregullore për vendosjen e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) duke përcaktuar strukturat personat përgjegjës detyrat afatet, lidhur me hartimin ndjekjen e faturave të detyrimeve për çdo leje legalizimi të lëshuar, shlyerjen e detyrimeve, ndjekjen dhe evidentimin e detyrimeve të papaguara ose që nuk kanë plotësuar afatin e likuidimit, me synim administrimin e të ardhurave nga për buxhetin e shtetit nga procesi i legalizimeve dhe transferimi i pronësisë, por edhe evidentimin, identifikimin e barrëve mbi pasurin (me origjinë nga legalizimet) në procesin e mëvonshëm të regjistrimit të pasurive të legalizuara, në përmbushje dhe harmonizim të kërkesave të ligjit “Për Kadastrën”.

Brenda muajit Dhjetor 2019

10. Gjetje nga auditimi: ALUIZNI-i Korçë, Sektori Financës, për vitin 2017 dhe vitin 2018 Ditarin e Bankës së të Ardhurave ka mbajtur, plotësuar në formatin ligjor përkatës, ka disa mangësi në kolonat “nr. Referimi”, “Përshkrimi”, **përmban te plote përshkrim e veprimit, por** nuk pasqyrohen qartë dhe objektivisht regjistrimet kontabile për lëvizjen e aktiveve në lekë e në bono të hyra nga procesi i legalizimit, për emra personash në shmangie e mos referencë të numrit të lejes legalizimit apo dhe evidentimit të raste-personave mbajtës të mbi dy lejeve të legalizimit me pasojë risku në të ardhurat; në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar Kreu I-rë, neni 3, pika 8, germa “c”, Kreun II, neni 6, pika 2, Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për Përcaktimin e Mënyrës së Mbledhjes dhe Administrimit të të Ardhurave për Ndërtimet pa Leje dhe Vlerave të Zbatueshme për Legalizim”, UMF nr. 30, datë 29.12.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”; pasqyruar në tabelën emërtuar “*Arkëtimet Mujore dhe vjetore të Ardhurave nga Legalizimet, sipas Ditarit Bankës, numri dhe rakordimet me thesarin për Vitet 2017 dhe 2018*” ekzistenca e të cilës do të ndihmonte saktësinë e procesit pasues të regjistrimit

dhe çeljes së KPP të pasurisë por dhe pasqyrimin e gjendjes juridike, nga Agjencia Shtetërore Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë konform ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, pasqyruar në kol nr.12 të tabelës emërtuar “*Arkëtimet Mujore dhe vjetore të Ardhurave nga Legalizimet, sipas Ditarit Bankës, numri dhe rakordimet me thesarin për Vitet 2017 dhe 2018*” (Trajtuar në faqet 87-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë (për ish-DR ALUIZNI-t Korçë), Drejtori, Sektori i Financës të marrë masa të mbajë në formatin ligjor të kërkuar Ditarin e Bankës për të ardhurat e arkëtuara dhe detyrimet e papaguara, nga legalizimet e ndërtimeve informate si dhe të regjistrojë kronologjikisht veprimet dhe ngjarjet, mbështetur rakordimet periodike (mujore 3/mujore vjetore) me sektorin e legalizimeve për (produktin apo shërbimin nëpërmjet dokumentacionit), duke identifikuar, përfshirë, përshkruar e vendosur në korrespondencë numrin, datën e lejës legalizimit, emër mbiemër të personit mbajtës të lejes, së cilës i korrespondojnë faturat, autorizimet e pagesave, por sidomos edhe shkresat njoftuese drejtuar NJQVV-ve për vlerën e detyrimit në lekë të taksës së infrastrukturës, etj., me synim administrimin e mbledhjes të ardhurave evidentimin e barrëve mbi titujt e pronësisë përfituar nga legalizimi, saktësinë në procesin pasues të regjistrimit dhe çeljes së KPP të pasurisë, nga Agjencia Shtetërore Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë

Brenda muajit Dhjetor 2019

11. Gjetje nga auditimi : Për nëpunësit e Drejtorisë ALUIZNI-t Korçë zbatohet procedura e Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” me ndryshime me VKM nr. 11 datë 14.01.2015 “Për përcaktimin e punonjësve me kontratë” Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë (për ish-DR ALUIZNI-t Korçë), në zbatimin ndjekjen menaxhimin e realizimit të treguesve të Buxhetit për veprimtarinë e viteve 2017 dhe 2018 ka Parashikime me rezerva, buxhete të pa argumentuar dhe mosrealizime përkatësisht: në vitin 2017 realizuar 96% kjo diference kryesisht në artikullin paga dhe sigurime shoqërore (nga mos parashikimi i saktë), kurse sipas burimeve mosrealizimet kanë ardhur nga burimi i financimit prej të ardhurave; gjendje kjo e krijuar nga veprimet ose mos veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” në mosrespektim të kriterit rritjes, në kundërshtim me ligjin nr.9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet përkatëse, si dhe me ligjin nr. 130/2016 “Për Buxhetin e Vitit 2017”, ligjin nr.109/2017 “Për Buxhetin e Vitit 2018”, dhe të Kapitulli IV pika 256 UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, sikundër pasqyruar në kolonat 6, 7, 8, 9 të tabelës emërtuar “Hartimi miratimi dhe realizimi i objektivave të buxhetit DR ALUIZNI Korçë viti 2017 dhe viti 2018” (Trajtuar në faqet 87-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë, (për ish-DR ALUIZNI-t Korçë), Drejtori, me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, të marrin masa të vazhdueshme për menaxhimin dhe ndjekjen e treguesve ekonomik dhe financiar të zbatimit të Buxhetit periodik e vjetor dhe në situata mosrealizimi apo pamjaftueshmërie si dhe të marrë masa në kohën e duhur për ndryshimet përkatëse ne zbatim të procedurave, me synim shmangien e mospërdorimit apo të pamjaftueshmërisë dhe të pasojës në mos përmbushjen e objektivave të institucionit.

Brenda muajit Dhjetor 2019

12. Gjetje nga auditimi : Nga Auditimi u konstatua se për periudhën objekt i këtij auditimi, nga ana e Sektorit të Financës janë bërë regjistrimet e transaksioneve ekonomike në ditarët e llogaritë përkatëse, është mbajtur kontabiliteti si ditar i veprimeve me magazinën, ditar i veprimeve me bankën, ditar i pagave veprime këto sipas kërkesave të ligjit nr.9228, datë 29.04.2014 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit 10296,date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 248 datë 10.04.1998, i ndryshuar, “Për miratimin e planit kontabel publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore, qendrorë e lokale si dhe njësive që varen prej

tyre”, UMF nr.14, datë 28.12.2006 “si dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

-ALUIZNI-i Korçë, Sektori Financës, për secilin prej viteve 2017 dhe 2018 nuk ka rakordim vjetor dhe periodik me Bankat lidhur me arkëtimet me bono thesari të pagesave për parcelat ndërtimore pasqyruar në Ditarin përkatës, megjithëse lejet e legalizimeve janë lëshuar e posedohen nga mbajtësit, vlera të cilat përbejnë gati mbi 50 % të vlerës totale të të ardhurave nga transferimi i pronave dhe legalizimeve të ndërtimeve pa leje (*Trajtuar në faqet 93-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1.Rekomandim: Drejtoria Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë, (për ish-DR ALUIZNI-t Korçë), Sektori i Financës, të marrë masa për kryerjen e rakordimeve periodike mujore e vjetore në vazhdimësi me Bankat lidhur me arkëtimet me bono thesari të pagesave për parcelat ndërtimore të regjistruara në ditarët e bankës së të Ardhurave

Menjëherë e në vijimësi.

13.Gjetje nga auditimi: Drejtoria Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë, (Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë, Sektori i Financës dhe Sektori i Legalizimeve në cilësinë e Autoritetit Ligjor të Prodhimit të Dokumentacionit të Legalizimeve të Objekteve informale) për secilin prej viteve 2017 dhe 2018 nuk ka evidence debitorësh dhe asnjë rakordim me NJVQV-të bashkitë Korçë, Maliq, Pogradec, Devoll dhe Kolonjë, lidhur me arkëtimin shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga pagesa e tarifës ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara nga ndërtimet informale (*Trajtuar në faqet 93-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1.Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë, Sektori i Financës dhe Legalizimit të marrin masa dhe të hartojë evidenca për debitorët dhe të kryej rakordimet me NJQVV-të, bashkinë Korçë, Maliq, Pogradec, Devoll dhe Kolonjë, lidhur me arkëtimin shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara nga ndërtimet informale.

Menjëherë e në vijimësi.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, në baze të nenit 9, pika 2, germa ç të ligjit nr. 111/2018, datë 7.2.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kontratën individuale të punës, **t’i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore në “**Vërejtje**” deri në “**Vërejtje me paralajmërim**”, për këta punonjës:

Masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”

- 1. z. K.T.**, me ish-Drejtor aktualisht N/Drejtor ASHK Korçë,

Për të metat e mangësi të konstatuara rast pas rasti, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore pasi:

Në 8 raste nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Korçë (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë) nuk është respektuar afati 60 ditor për marrjen e vendimit për

kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është mbajtur procesverbali i konstatimit në terren, ndërkohë që në 5 raste nuk është respektuar afati 30 ditor për lëshimin e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit, veprime këto në kundërshtim me: pikën 8 të VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 i ndryshuar “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar, pika 2 e VKM nr.954, datë 25.11.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit” me ndryshime; Në 6 raste, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët, madje është çenuar trupi i rrugës ku sipas Gen Planit të administruar në dosje rezultojnë se objektet bien mbi rrugë a trotuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 39 “Përjashtimi nga legalizimi” me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” kreu III. “Kriteret për legalizimin e ndërtimeve jashtë zonave informale të miratuara”, pika 4/b ku -Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 i ndryshuar “Kodi rrugor në Republikën e Shqipërisë”, neni 2 “Përcaktime dhe klasifikime rrugësh” dhe neni 4, “Përcaktimi i qendrave të banuara” -VKM nr. 153, date 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 2; ndërkohë që në dosje nuk ka korrespondencë shkresore me Autoritetin Rrugor Shqiptar për të përcaktuar nëse parcela ndërtimore bie në rrugë apo mbi projektin infrastrukturor; 2 rast është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar në buzë të lumit, përroi, kanal dhe digë pa respektuar distancat nga brigjet dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion i justifikues për këtë qëllim. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5, ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” Kreu III, pika 4, germat: “dh”; Në 6 raste, sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Pyll”. Pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk ka gjetur zbatim të neneve 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve e të dokumentacionit, për propozimin e miratimin e zonave informale” i ndryshuar gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall”; Në 4 raste në Procesverbalin e Verifikimit në Terren nuk është përcaktuar funksioni i ndërtimit informal, ndërsa në planimetritë që shoqërojnë Lejen e Legalizimit është përcaktuar funksioni veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar neni 3 “Përkufizime” pika “a”, si dhe neni 17 “Kalimi i së drejtës së pronësisë dhe mënyra e pagesës së parcelës ndërtimore” pika 3; Në 1 raste, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur dhe pamjes grafike të ASIG rezultojnë se objekti ndodhet mbi një objekt tjetër, dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej verifikimit të pronësisë së parcelës ndërtimore si dhe marrëdhënive me objektin e vjetër, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion i justifikues për këtë qëllim. Veprimet janë në kundërshtim me: neni 39, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar pika 13; Në 1 raste, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, fotove të objektit dhe pamjes grafike të ASIG rezultojnë se objekti është i ndërtuar me objekte jo të qëndrueshme (llamarinë etj.) dhe pa lidhur pazgjidhshmërisht me tokën pra jashtë fushës së zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Veprimet në

kundërshtim me: nenit 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006; VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, ndryshuar pika 1 e 7; Në 1 raste Sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si vetëdeklarimi (i regjistruar edhe në faqen zyrtare të ALUIZNI-t) fotografitë e objektit si dhe imazhet satelitore konstatohet se objekti informal i vetëdeklaruar është ndërtuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, nenin 2 “Fusha e zbatimit”; me VKM nr. 589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale” i ndryshuar, pika 3 e 3/1; Në 1 rast në lëshimin e lejes së legalizimit është pranuar Deklaratën e vetëdeklarimit të ndërtimit informal, pa u shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar dhe objekti informal ndodhet në zonë me përparësi në zhvillimin e turizmit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 767, date 10.09.2014 “Për miratimin e formës dhe mënyrës së plotësimit dhe administrimit të deklaratës për përfshirjen në procesin e legalizimit të ndërtimit pa leje” dale në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9482, data 03.04.2006, i ndryshuar si dhe pikës 2 të VKM nr. 589, date 10.09.2014 i ndryshuar; nenin 38/1; VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar ndërtime pa leje, shtesa anësore dhe /ose në lartësi në ndërtimet me leje”, ndryshuar me VKM nr. 756, datë 26.10.2016, Kreu III, pika 6.

Masa “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”

1. z. M.A., me detyrë Specialist,
2. z. Gj. RR., me detyrë Specialist,
3. z. V. Q. me detyrë Specialist,

Për të metat e mangësi të konstatuara rast pas rasti sipas specialistëve, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore pasi:

-Në 24 rastet “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa leje/shtesë në ndërtimin me leje”, pasqyron kufitarët e parcelës ndërtimore të zënë vetëm me nr. pasurie pa përshkrim, nuk janë përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës. Skicat fushore pasqyrojnë përmasat e objektit informal, por nuk kanë të pasqyruara: ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti të kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Veprime në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 30, datë 15.01.2016 “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (gen plan, planimetri)

-Në 4 raste në Procesverbalin e Verifikimit në Terren nuk është përcaktuar funksioni i ndërtimit informal, ndërsa në planimetritë që shoqërojnë Lejen e Legalizimit është përcaktuar funksioni veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar neni 3 “Përkufizime” pika “a”, si dhe neni 17 “Kalimi i së drejtës së pronësisë dhe mënyra e pagesës së parcelës ndërtimore” pika 3.

II. Për 3 punonjës aktual në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, nuk propozojmë masë, pasi shkalla e shkeljeve në raport me pasojat në mirë funksionimin e institucionit, nuk është në nivelin për propozim masë disiplinore, si më poshtë: z. Mariglen Disha, Agim Trebicka, Zhuljen Manellari.

III. Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional

Për **10 ish-punonjës** dhe ish drejtuesit sipas shkallës së përgjegjësisë masa disiplinore e propozuar nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara, do të ishte **“Vërejtje me paralajmërim”** deri në **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, nuk rekomandojmë masa disiplinore, pasi nuk kemi adresim institucional për marrëdhënie pune në administratën publike, përkatësisht:

- | | |
|----------|----------------------------|
| 1. M.P, | me detyrë ish-Drejtor, |
| 2. K.M., | me detyrë ish-P/Sektori, |
| 3. G.K. | me detyrë ish P/Sektori |
| 4. N.L. | me detyrë ish-P/Sektori |
| 5. G.S. | me detyrë ish- Specialist, |
| 6. E.M. | me detyrë ish- Specialist, |
| 7. DH.P. | me detyrë ish- Specialist, |
| 8. K.B. | me detyrë ish- Specialist, |
| 9. H.H. | me detyrë ish- Specialist, |
| 10. A.G. | me detyrë ish- Specialist |

D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr.152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R